



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

Efektet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit Kosovë - BE: Ndikimi në Tregti

Qershor 2017

Përmbajtja

Akronimet	3
Përmbledhja Ekzekutive.....	4
Kapitulli 1: Hyrje.....	5
Kapitulli 2: Kosova dhe Procesi i Stabilizim Asociimit	7
2.1 Historiku i ekonomisë së Kosovës	7
2.2 Situata e tanishme ekonomike	8
2.3 Tregtia në Kosovë.....	10
2.4 Procesi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit BE-Kosovë	13
2.4.1 Çfarë është rëndësia ekonomike e MSA-së?	13
2.4.2 Detajet e pjesës tregtare të MSA-së	14
2.4.3 Koncesionet e BE-së për prodhimet industriale të Kosovës	14
2.4.4 Koncesionet BE-së për produktet bujqësore të Kosovës.....	14
2.4.5 Koncesionet e Kosovës ndaj produkteve industriale të BE-së	14
2.4.6 Koncesionet e Kosovës ndaj produkteve bujqësore të BE-së	15
2.4.7 Koncesionet e Kosovës ndaj BE-së për produktet e peshkut.....	15
Kapitulli 3: Analiza e zbatimit të MSA-së	17
3.1 Ndikimi në Tregti me Mallrat	17
3.2 Ndikimi në Tregti me Shërbimet	19
3.3 . Mbrojtja e tregut.....	20
Kapitulli 4: Konkluzionet	21

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Të dhënat e popullsisë.....	7
Tabela 2 Treguesit kryesorë ekonomik të Kosovës.....	7
Tabela 3 Kosovë - treguesit kryesorë makroekonomik, 2001-2014	8
Tabela 4 Tregtia në Shërbime / Bilanci Prill 2016 – Mars 2017	12
Tabela 5 Eksporti i Shërbimeve / Top Sektorët Prill 2016 – Mars 2017	12
Tabela 6: Eksporti (Prill – Dhjetor 2015- 2016).....	18
Tabela 7 Importi (Prill – Dhjetor 2015- 2016).....	18

LISTA E KUTIVE

Kutia 1 : DATAT E RËNDËSISHME LIDHUR ME NEGOCIATAT PËR MSA.....	16
---	----

Akronimet

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore
ERA	Agjenda për Reforma Evropiane
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IHD	Investimeve të Huaja Direkte
KE	Komisioni Evropian
KSA	Këshilli i Stabilizim Asociimit
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
PKZMSA	Programi për Zbatimin e MSA-së
PVK	Pika e Kontaktit të Vetëm

Përmbledhja Ekzekutive

Ky material shqyrton përmbajtjen dhe rëndësinë e MSA-së si dhe efektin tregtar të saj në kontekst të shkëmbimeve tregtare në periudhë 1 vjeçare të zbatimit të saj që nga hyrja në fuqi në muajin Prill 2016.

MSA e cila është nënshkruar në tetor 2015 synon të mbështesë tranzicionin ekonomik të Kosovës, si dhe të forcojë integrimin e saj në tregun e BE-së. Agjenda e reformës së Kosovës nën MSA është mbresëlënëse, duke mbuluar fushat që fillojnë nga dialogu politik dhe bashkëpunimi rajonal për liritë e komunitetit në lëvizjen e mallrave, shërbimeve, punëtorëve dhe kapitalit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë në drejtësi dhe në punët e brendshme. Ajo kërkon tregti të gjerë liberalizimi karshi vendeve të BE-së dhe anasjelltas dhe siguron liberalizim substancial jo-tarifor nëpërmjet harmonizimit gradual me strukturat e BE-së dhe direktivat në fushat e standardeve, certifikimit, administrimit doganor, konkurrencën dhe të drejtat e pronësisë intelektuale.

MSA është marrëveshje ndërkombëtare e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, qëllimi i së cilës është themelimi i marrëdhënieve formale dhe kontraktuale ndërmjet dy palëve me qëllim të anëtarësimit të Kosovës në BE. Për me tepër, në thelb të MSA-së qëndron aspekti ekonomik që përbën edhe qëllimin kryesor të MSA-së ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Po ashtu është e rëndësishme se nga kjo marrëveshje Kosova ka marrë përsipër një varg të obligimeve sidomos në aspektin ekonomik apo fushën e tregtisë e të cilat i obligojnë institucionet e vendit që të jenë me të përkushtuara në përmbushjen e tyre, në mënyrë që MSA të sjell përfitimet e pritura për Kosovën.

Nga analiza e të dhënave statistikore për periudhën pas lidhjes së marrëdhënieve kontraktuale Kosovë – BE, përkatësisht pas nënshkrimit të MSA-së siç tregohet në dokument eksportet totale në BE shfaqin tendencë negative krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Niveli i vlerave të eksportit dhe gama shumë e kufizuar e mallrave me origjinë kosovare është një tregues që shpreh nivelin e konkurrueshmërisë në raport jo vetëm me ekonomitë e vendeve të zhvilluara por edhe me vendet me ekonomi në zhvillim si ato të rajonit.

Dokumenti do të fokusohet edhe në paraqitjen e nivelit dhe kohëzgjatjes së liberalizimit të produkteve bujqësore dhe industriale Kosovë-BE dhe anasjelltas.

Kapitulli 1: Hyrje

Procesi i Stabilizim Asociimit për Ballkanin Perëndimor është politikë kyçe e BE-së, me qëllim të anëtarësimit të tij në BE. Procesi është lansuar në qershor 1999 dhe rikonfirmuar në Samitin e Selanikut në qershor 2003. Kosova ka qenë pjesë e procesit integruar të Ballkanit Perëndimor qysh nga viti 2002, kur ka filluar procesi i Mekanizmit Përcjellës të procesit të Stabilizim Asociimit. Në vitin 2009, ky proces është avancuar në Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit. Sidoqoftë, asnjëri nga këto dy mekanizma nuk kanë qenë instrumentet zyrtar të Bashkimit Evropian për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. BE-ja, për shkak të 5 vendeve që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, nuk ka qenë në gjendje t'i ofrojë Kosovës proces të njëjtë anëtarësimi sikur për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky proces për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor ka filluar me lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). MSA-ja përfaqëson marrëveshjen më të rëndësime ligjore dhe politike e cila është themel i procesit të anëtarësimit në BE. Në vitin 2012, BE ka vendosur të përgatitë Studimin e Fizibilitetit për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Studimi konfirmoj se Kosova është kryesisht e gatshme të filloj negociatat për MSA. Për të filluar negociatat, Kosova duhet të përmbushte 4 kritere shtesë në sundimin e ligjit, tregti, reformën e administratës publike dhe mbrojtjen e minoriteteve. Në prill 2013, Komisioni Evropian konkludoj se Kosova i kishte përmbushur 4 kriteret dhe rrjedhimisht në korrik 2013 Këshilli dha dritën e gjelbër për nisjen e negociatave për MSA. Procesi negociator ka filluar me 28 tetor 2013, dhe rrjedhimisht janë mbajtur 5 takime në nivel të Kryenegociatorëve dhe dhjetëra takime të grupeve teknike. Procesi negociator u përmbyll me 2 maj 2014. Me 25 korrik 2014 marrëveshja është inicializuar, ndërsa me 22 tetor 2015 MSA u miratua në Këshillin e BE-së. Nënshkrimi i MSA-së u bë me 27 tetor 2015 në Strasburg. Kuvendi i Republikës së Kosovës ratifikoj Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me 2 nëntor 2015¹.

MSA është marrëveshje ndërkombëtare e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian qëllimi i së cilës është themelimi i marrëdhënieve formale dhe kontraktuale ndërmjet dy palëve me qëllim të anëtarësimit të Kosovës në BE.

Përmes MSA themelohet një Asociacion mes Kosovës dhe BE i cili ka për qëllim që vendit tonë t'i ofrohet:

- Përkrahje për përforcimin të demokracisë dhe sundimit të ligjit.
- Përkrahje për stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional, si dhe stabilizimin e rajonit.
- Kornizë e përshtatshme për dialogun politik që do të mundësojë zhvillimin e marrëdhënieve të afërta politike mes palëve.
- Përkrahje në zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, nëse rrethanat objektive lejojnë, edhe përmes përafrimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së.

¹ Burimi: http://www.mei-ks.net/repository/docs/permbledhja_per_msa-ne.pdf

- Përkrahje për kompletimin e tranzicionit në ekonomi funksionale të tregut.
- Përkrahje në promovimin e marrëdhënieve të mirëfillta ekonomike dhe zhvillim gradual të tregut të përbashkët në mes vendit tonë dhe BE-së.
- Përkrahje në përforcimin e bashkëpunimit rajonal në të gjitha fushat që mbulohen nga MSA.

MSA përmban 597 faqe, në 144 nene dhe X tituj:

- Preambula;
- Neni 1;
- Titulli I, Parimet e Përgjithshme;
- Titulli II, Dialogu Politik;
- Titulli III, Bashkëpunimi Rajonal;
- Titulli IV, Lëvizja e Lirë e Mallrave;
- Titulli V, Themelimi i ndërmarrjeve, Ofrimi i Shërbimeve dhe Lëvizja e Kapitalit;
- Titulli VI, Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me *Acquis* të BE-së, Zbatimi i Legjislacionit dhe Rregullat e Konkurrencës;
- Titulli VII, Liria, Siguria dhe Drejtësia;
- Titulli VIII, Politikat e Bashkëpunimit;
- Titulli IX, Bashkëpunimi Financiar;
- Titulli X, Dispozitat Institucionale, të Përgjithshme dhe Përfundimtare.

Po ashtu, pjesë përbërëse e marrëveshjes janë 7 shtojcat dhe 5 protokolle, qëllimi i së cilave është sqarimi apo detajizimi i mëturshëm i neneve të ndryshme të marrëveshjes:

SHTOJCAT

- Shtojca I (Neni 23), Tarifat koncesionare të Kosovës për produktet industriale të BE-së;
- Shtojca II (Neni 28), Përkufizimi i produkteve të "*mishit të viçit*";
- Shtojca III (Neni 29), Tarifat koncesionare të Kosovës për produktet bujqësore të BE-së;
- Shtojca IV (Neni 31), Koncesionet e BE-së për produktet e peshkut të Kosovës;
- Shtojca V (Neni 32), Tarifat koncesionare të Kosovës për peshkun dhe produktet e peshkut të BE-së;
- Shtojca VI (Neni 50), Themelimi: Shërbimet financiare;
- Shtojca VII (Neni 77), Të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

PROTOKOLLET

- Protokolli I (Neni 27), Tregtia mes BE-së dhe Kosovës së produkteve të përpunuara bujqësore;
- Protokolli II (Neni 30), Verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara;
- Protokolli III (Neni 46), Përkufizimi i termit "*origjina e produkteve*";
- Protokolli IV (Neni 104), Asistenca reciproke administrative në çështjet doganore;
- Protokolli V (Neni 136), Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

Kapitulli 2: Kosova dhe Procesi i Stabilizim Asociimit

2.1 Historiku i ekonomisë së Kosovës

Kosova është një vend pa dalje në det në Evropën Juglindore dhe kufizohet me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Në vitin 2015, popullsia e përgjithshme e Kosovës është vlerësuar të jetë 1,797 milion banorë.

Popullsia

Në vitin 2015, popullsia e vlerësuar e Kosovës ishte 1,797 milion banorë. Me më shumë se 70% të popullsisë nën moshën 35 vjeç, Kosova ka popullsinë më të re në Evropë.

Tabela 1 Të dhënat e popullsisë

Popullsia rezidente (e vlerësuar, 2015)	1,801 milion
Norma e rritjes (2015)	-1,1 për qind
Norma e analfabetizmit (2011)	3,85 për qind
Jetëgjatësia mesatare (2015)	71

Treguesit kryesorë ekonomik

Tabela 2 më poshtë përmbledhë treguesit kryesorë ekonomik të Kosovës.

Tabela 2 Treguesit kryesorë ekonomik të Kosovës

	2012	2013	2014	2015	2016
BPV-ja (US\$ /mil.)	5.957,2	7.073,02	5.957,2	6.213,5	6.470,1
Norma e rritjes së BPV-së (në %) ²	4,5%	2,7%	1,2%	4,0%	3,6%
BPV (€ për kokë banori)	2.799	2.935	3.023	3.126	3.213
Inflacioni (në %) ³	2,5	1,8	0,4	-0,5	0,1
Shkalla e papunësisë	30,9	30	35,3	32,9	/
Bilanci i pagesave (€ mil.)	-280,2	-144,3	-363,4	-471,4-	-395,8 ⁴
Investimet direkte në Kosovë (€ mil.)	229,1	280,2	151,2	324,4	148,0 ⁵
Kursimet (totali i depozitave) (€ mil.)	2.279,1	2.449,0	2.537,5	2.702,9	2.897,9
Kreditë e aprovuara (kreditë bruto) (€ mil.)	1.763,4	1.805,8	1.882,3	2.019,5	2.230,0
Ekonomia gri	-	-	-	-	-

Ekonomia gri: Deri më sot, nuk ka pasur asnjë analizë gjithëpërfshirëse të ekonomisë joformale në Kosovë. Vlerësim i fundit i kryer nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) në vitin 2007, vlerësim i cili miratoi përkufizimet e OBZHE-së dhe modelin e buxhetit makroekonomik të ekonomive familjare, vlerëson madhësinë e ekonomisë joformale në Kosovë të jetë në mes të 27 dhe 35 për qind të PBV-së në vitet 2004-2006. Gati 85 për qind e kësaj i atribuohet punëtorëve të cilët nuk paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore ose tatimin mbi të ardhurat personale.

² Burimi: Treguesit e Bankës Botërore për Kosovën

³ Burimi: Raporti Vjetor i Bankës Qendrore, 2013, fq. 12 (<http://bqk.kos.org/repository/docs/2014/CBK%20AR%202013-english.pdf>)

⁴ Të dhënat janë deri në gusht 2016

⁵ Të dhënat janë deri në gusht 2016

Shikuar gjerësisht, që nga fillimi i procesit të tranzicionit të pas luftës në vitin 1999, Kosova ka përjetuar norma premtuese të rritjes ekonomike. Vrulli i rritjes ekonomike të periudhës së menjëhershme të pasluftës (e cila arriti kulmin në 27 për qind më 2001) është nxitur në një masë tejet të madhe nga flukset jashtëzakonisht të larta të ndihmës për zhvillim dhe rindërtim – të dyja nga të cilat promovuan shpenzimet e ekonomisë familjare dhe qeveritare dhe kështu katalizuan aktivitetin ekonomik. Ndihma neto zyrtare për zhvillim arriti në 72 për qind të BPV-së në vitin 2001, viti i parë ku të dhënat e ndihmës janë dispozicion. Meqë ndihmat fillestare të pas luftës u dhanë dhe flukset e ndihmave vendnumëruan në rreth 10 për qind të BPV-së, rritja ekonomike ka qenë e qëndrueshme në nivele të moderuara. Në mes të viteve 2002-2014, rritja e BPV-së varionte midis 0 për qind dhe 7 për qind, ndërsa rritja mesatare e të ardhurave për kokë banori mbeti rreth 3.1 për qind.

Tabela 3 Kosovë - treguesit kryesorë makroekonomik, 2001-2014

Treguesit	2001	2004	2007	2010	2014	Mesatarja ^b
BPV (konstante, m €)	2,946.6	3,181.9	3,782.8	4,145.4	4,714.0	3,847.6
Rritja e BPV-së(vjetore,%)	27.0	2.6	7.3	3.3	2.5	3.7
BPV për kokë banori (konstante, €)	1,732.1	1,866.7	2,182.3	2,334.5	2,585.6	2,188.1
Rritja e BPV për kokë banori (vjetore,%)	26.9	2.5	6.4	2.5	2.2	3.1
Papunësia, gjithsej (% e totalit të fuqisë punëtore)	57.0	39.7	46.3	-	30.9 ^a	44.5
Inflacioni, çmimet e konsumit (vjetore, %)	-	-1.0	4.3	3.5	0.4	2 ^c

Burimi: Banka Botërore Treguesit e Zhvillimit Botëror (vite të ndryshme)

Shënim: ^a 2012b mesatarja në mes të 2002-2014 c mesatarja në mes të 2003-2014

Ndërsa, nominalisht e moderuar, ecuria e përgjithshme e rritjes ekonomike në Kosovë mbetet e dobët dhe e brishtë. Normat e larta të rritjes së BPV kryesisht pasqyrojnë nivelet e ulëta fillestare të BPV-së të shkaktuara nga kolapsi ekonomik i shkaktuar nga lufta. Ato gjithashtu u nxitën nga një proces i rimëkëmbjes që përfshin një kthim në shkallë të gjerë të refugjatëve që kishin ikur nga vendi i tyre gjatë luftimeve. Në të njëjtën kohë, nivelet e larta të informalitetit ekonomik sugjerojnë se shifrat për të ardhurat për kokë banori mund të nënvlerësojnë nivelet aktuale të të ardhurave të disponueshme të ekonomive familjare.

2.2 Situata e tanishme ekonomike

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja nominale gjatë periudhës 2014-2016 është rritur nga 5.567,5 milionë euro në 6.046,8 milionë euro. BPV-ja për kokë banori ka rënë

nga 4.073,8 USD në vitin 2014, në 3.561,6 USD në vitin 2015.⁶ Në vitin 2016, sipas parashikimeve të BQK-së, BPV-ja në Kosovë arriti në 6.470,1 USD, në krahasim me 5.957,2 USD në vitin 2010. BQK-ja parashikoi një rritje reale të normës së PBV-së prej 3,6% në vitin 2016, krahasuar me një rritje reale të BPV-së prej 4,0% në vitin 2015, siç është vlerësuar nga ASK-ja. Pavarësisht anës pozitive se ndikimi i përgjithshëm i krizës ekonomike ka qenë më i vogël në Kosovë sesa në vendet fqinje, është e qartë se një rënie në Evropë (si partneri kryesor tregtar) lë Kosovën të cënueshme ndaj goditjeve ekonomike, përmes rënies në eksportet dhe remitencat. Në vitin 2015, aktiviteti ekonomik është udhëhequr kryesisht nga pozita e investimeve që shënoi një rritje prej 10,7%. Për më tepër, konsumi i përgjithshëm shënoi një rritje prej 2,1 për qind në vitin 2015, i udhëhequr kryesisht nga konsumi familjar. Nga ana tjetër, baza e ulët e eksporteve si dhe një rritje më e shpejtë e importeve të mallrave dhe shërbimeve në krahasim me eksportet e mallrave dhe shërbimeve çuan në një rritje në pozicionin neto të eksportit prej 3,3 për qind. Në vitin 2016, në bazë të parashikimeve të BQK-së, Kosova pritet të shënojë një rritje prej rreth 3,6 për qind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa eksportet neto pritet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në normën e rritjes së PBV-së. Norma e inflacionit në vitin 2016 ishte 0,1% në krahasim me -0,5% të regjistruar në vitin 2015. Pjesë e arsyes për shkallën e ulët të inflacionit janë çmimet e favorshme të produkteve të importuara, që reflektojnë presionet deflacioniste në vendet e Eurozonës me të cilat Kosova zhvillon shumicën e shkëmbimeve tregtare. Megjithatë, Kosova mbetet e ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimeve, për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe. Sipas shifrave zyrtare, normat e papunësisë në Kosovë mbeten të larta, me një normë mesatare të papunësisë prej 32,9% dhe një normë të ulët punësimi (25,2%) në vitin 2015. Papunësia e të rinjve vazhdon të jetë veçanërisht e lartë, në rreth 57,7%.⁷ Ulja e papunësisë dhe krijimi i vendeve të reja dhe cilësore të punës përmes rritjes ekonomike dhe rritjes së eksporteve është një objektiv kyç i Qeverisë së mëparshme dhe asaj të tanishme. Pjesëmarrja e investimeve në BPV është llogaritur të jetë 25,8% në vitin 2014, një nivel i ngjashëm me atë të vitit 2013. Megjithatë, kontributi kryesor në rritjen e investimeve ishte dhënë nga sektori privat në vitin 2014, ndërsa në vitet e mëparshme investimet kapitale të sektorit publik janë konsideruar si kontribuesi kryesor. Një rritje e investimeve private (rreth 60% e investimeve totale) është vlerësuar të jetë rezultat i rritjes së investimeve të huaja direkte (IHD) dhe kredive për investime. Politikat fiskale u përkeqësuan në vitin 2014, pas rritjes së shpenzimeve buxhetore, të frymëzuar nga zgjedhjet. Në kontekstin e Marrëveshjes Stand-By (2012-13), mbështetur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Qeveria kishte arritur të adresonte pabarazitë fiskale që rezultonin nga premtimet e zgjedhjeve të përgjithshme për paga më të larta në fund të vitit 2010. Në një përpjekje për ta ruajtur stabilitetin fiskal afatgjatë të Kosovës, u miratua një rregull fiskale për të shërbyer si spirancë kryesore fiskale e Qeverisë. Megjithatë, të hyrat më të ulëta se sa të projektuara dhe vendimet politike (të frymëzuara nga zgjedhjet) për (i) t'i rritur pagat e sektorit publik dhe pensionet për 25 për qind; (ii) për të futur përfitime të reja sociale për të burgosurit politik dhe

⁶ Burimi: World Bank country data Kosovo

⁷ Anketa e Fuqisë Punëtore të Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015.

veteranët e luftës; dhe (iii) për ta nënshkruar kontratën për një projekt për ndërtimin e autostradës të financuar nga buxheti (me qëndrueshmëri të kufizuar ekonomike) përmbysën fitimet e konsolidimit të bëra gjatë periudhës ndërmjet mesit të vitit 2011 deri në fund të vitit 2013 dhe bënë të domosdoshme një tkurrje të madhe në shpenzimet kapitale për ta mbajtur deficitin fiskal nën 2,0% për qind të BPV-së, afër kufirit të përcaktuar në rregullin fiskal.

2.3 Tregtia në Kosovë

Përmbledhje e tregtisë së jashtme të Kosovës

Shoqëria kosovare ende ballafaqohet me një varg problemesh dhe vështirësish për t'iu bashkangjitur rrjedhave aktuale të zhvillimit ndërkombëtar veçmas në sferën ekonomike. Kështu, çështjet që lidhen me tregtinë e jashtme të Kosovës, përkatësisht situata e përgjithshme tregtare jep një pasqyrë mbi gjendjen aktuale ekonomike, në një mënyrë shkallën e zhvillimit ekonomik ku e shprehin edhe treguesit e tregtisë së jashtme dhe për këtë analiza e ecurisë dhe vëllimit të tregtisë së jashtme nxjerr në pah gjendjen faktike të sektorëve prodhues vendor. Në sektorin e mallrave bilanci i tregtisë së jashtme është mjaft negativ i përcjellur nga viti në vit. Duke marr për bazë se sektori i tregtisë së jashtme ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik, andaj politika tregtare është një nga instrumentet kryesore të politikës së përgjithshme ekonomike. Mbi të gjitha shifrat japin një pasqyrë të qartë për bilancin tregtar të Kosovës e cila ka një deficit shumë të lartë tregtar evidente për vite të tera duke tejkaluar 2 miliard euro. Situata tjetër kemi te sektori i shërbimeve ku nga viti në vit bilanci i tregtisë në shërbime është pozitiv, duke gjeneruar të hyra në buxhetin e Kosovës dhe duke e bërë më konkurrues këtë sektor.

Bilanci tregtar i mallrave

Këmbimet tregtare të Kosovës, gjatë vitit 2016, arritën vlerën mbi 3 miliard Euro, tregues i cili shënoj rritje për 4.7% në raport me vitin 2015, trend që reflekton një tendencë të rritjes së importeve dhe rënie të eksporteve. Importet e mallrave në Kosovë arritën vlerën prej mbi 2.7 miliard Euro duke ndjekur një ecuri vjetore më të lartë me atë të vitit 2015 (me një rritje vjetore prej 5.9 %). Lëvizja e çmimeve për disa mallra në tregjet ndërkombëtare pati si pasojë ecurinë e vlerës së eksporteve kosovare me ndikim edhe në tregtinë e jashtme të Kosovës. Çmimet të cilat më së shumti shënuan rënie janë çmimet e metaleve bazë të cilat kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në tregtinë e Kosovës. Peshat e eksporteve në BPV është mjaft e vogël dhe jo shumë premtuese edhe për një periudhë të gjatë kohore. Trendet e saj pothuajse janë të pandryshuara dhe pjesëmarrja e tyre gjatë viteve të fundit nuk tejkalojnë 5%. Eksportet e Kosovës shënuan vlerën prej 309.6 milionë Euro në vitin 2016, apo 4.8% rënie, krahasuar me vitin 2015, rënie e cila ka rritur edhe më tutje bilancin negativ tregtar të Kosovës. Nga krahasimi i mallrave të eksportuara në vitin 2016 në raport me vitin 2014 situata është e ngjashme me atë të vitit paraparak, andaj në vitin 2016 kemi një rënie të eksporteve për 4.6% në raport me vitin 2014. Kosova në masë të madhe është e varur nga importet, si rrjedhojë, mbulimi i importeve nga eksportet u zvogëluar në 11% (2016) krahasuar me 12.3% që ky tregues ishte në vitin 2015.

Struktura e tregtisë së jashtme

Sa i përket strukturës së eksporteve ato ende mbesin të njëjta si me vitet e mëparshme. Eksportet janë të dominuar nga metali i papërpunuar (apo mbeturinat metalike) dhe produktet minerale. Kosova ka eksportuar mbi 175 milion Euro të këtyre dy grupeve të produkteve që përbën 56.5 për qind e totalit të eksporteve. Po ashtu, produktet bimore dhe ushqimore mbulojnë një përqindje të konsiderueshme të eksportit 14.4 për qind e eksporteve të përgjithshme. Vlen të theksohet se në vazhdimësi në industrinë e sektorit të ushqimit kemi një rritje të eksporteve si krahas vitit 2015 për 8.7 %. Por, nëse i analizojmë të dhënat e vlerës së eksporteve për mallrat e këtij sektori me vitin 2014 shohim se kemi një rritje të lartë për 35%, çka do të thotë se ky sektor është mjaft premtues. Rënia të eksportet kosovare më së tepërmi u reflektua në kategorinë e metaleve bazë, që njëherit ishte dhe është kategoria më e eksportuar gjatë viteve të tëra me rreth 35.9 përqind të totalit të eksporteve në (2016) dhe rënie për 29.5% krahas vitit 2015. Në krahasim me vitin 2014 eksportet e kësaj kategorie kanë shënuar rënie për mbi €56 milion (apo 34%), duke e rritur bilancin negativ tregtar të kësaj kategorie produktesh. Rënien e eksporteve të këtyre produkteve e shkaktoi rënia e çmimeve të metaleve në tregjet ndërkombëtare në dy vitet e fundit, faktor ky i cili ndikoi në rënien e vlerës së eksporteve të këtyre produkteve. Ndërsa, struktura e importeve në 2016 mbetet përafërsisht e njëjtë si në atë të vitit 2015. Importet dominohen nga produktet minerale (përkatësisht nga nafta dhe derivateve të saj) dhe kategoria e makinerive dhe paisjeve të cilat së bashku mbulojnë rreth 24.6% të totalit të importeve. Kur është fjala për produktet minerale duhet potencuar rënien e vlerës së importit për këtë kategori krahasuar me vitin paraprak. Importi i kësaj kategorie shënoi rënie për €76.6 milion në raport me vitin paraprak (apo për mbi 19 përqind). Përbërës të tjerë të rëndësishëm në strukturën e importeve janë produktet ushqimore të cilat gjatë vitit 2016 janë importuar në vlerë prej €373 milion. Por, kjo kategori e importit të këtyre produkteve u karakterizua me rritje të ndjeshme në raport me vitin 2015 për 5.8 %, pjesëmarrje prej 13.4% në importet e përgjithshme. Megjithatë, është evidente rritja e madhe e importit të mjeteve të transportit për €55.9 milion ose 7.9% në raport me vitin paraprak (2015). Por, në raport me vitin 2014 kemi rritje të jashtëzakonshme për këtë kategori mallrash më konkretisht për mjetet e transportit për 79 milion euro ose e shprehur në përqindje më e lartë për 56% krahas vitit 2014.

Tregtia sipas destinacionit

Volumi i tregtisë së jashtme me vendet e BE-së dhe vendeve të rajonit pjesëmarrës në bllokun CEFTA, përbën pjesën më të rëndësishme të shkëmbimeve tregtare të Kosovës, me rreth 70% të gjithë tregtisë së jashtme. CEFTA është një partner i rëndësishëm tregtar e cila mbulon 29% të shkëmbimit të përgjithshëm tregtar. Mallrat me origjinë kosovare që eksportohen në CEFTA mbulojnë 46.6% të totalit të eksporteve. Importet nga vendet e CEFTA-së janë mbi 753 milionë euro, rënie prej 2.1% ndaj vitit paraprak dhe mbulon 27% të importeve të përgjithshme. Gjatë vitit 2016, eksportet kanë shënuar, rritje prej 16.6% nga viti paraprak dhe po ashtu rritje për 13.5% ndaj vitit 2014. Vendet më atraktive për mallrat kosovare janë: Shqipëria, Serbia, dhe Maqedonia e ndjekur nga Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina. Megjithatë, kur është fjala për

tregtinë e Kosovës me pjesën tjetër të botës përjashtuar bllokun e BE-së dhe CEFTA-së, kuptojmë se partnerët tjerë atraktiv për eksportin e mallrave mbesin Zvicra, Kina, India dhe Turqia. Kurse, importet në Kosovë nga pjesa e mbetur e botës si partnerët kryesorë janë Turqia, Kina, SHBA, Brazili, Zvicra etj.

Bilanci tregtar i shërbimeve

Tregtia në shërbime në Kosovë për periudhën prill 2016 – mars 2017 ka arritur në total prej 1.5 miliard euro. Nga kjo shumë, totali i eksportit përfshinë një shumë prej 1.04 miliard euro, ndërsa importi një shumë të përgjithshme prej 437.1 milion eurove. Kjo tregon një bilanc tregtar pozitiv prej 567.5 milion euro. Nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë prill 2015-mars 2016, shohim se eksporti i shërbimeve ishte 966.7 milion euro, përderisa importi rezultoi me 478.2 dhe bilanci tregtar 478.2 milion euro në tregtimin ndërkombëtar të shërbimeve. Duke u bazuar në këto shifra, shohim se ka një trend pozitiv të rritjes së bilancit të shërbimeve për një shumë prej 89.3 milion euro. Sektorët kryesorë të cilët kontribuan drejt një bilanci tregtar pozitiv për periudhën prill 2016 – mars 2017 janë: udhëtimet (turizmi) me eksport në vlerën prej 809.6 milionë euro, e ndjekur nga shërbimet profesionale dhe të biznesit me 64.4 milion euro, shërbimet e komunikimit (ICT) me 48.6 milionë euro; dhe shërbimet qeveritare me 35.8 milionë euro; shërbimet e ndërtimit me 10.6 milion euro. Shërbimet e udhëtimit dhe turizmit kryesisht i atribuohen diasporës së Kosovës dhe shtetasve të huaj që punojnë në Kosovë. Trendi negativ i tregtisë në shërbime (sa i përket bilancit të shërbimeve) duket se çdo vit i përfshinë sektorët: transportin me -87.1 milion euro dhe shërbimet pensionale dhe të sigurimit me -23.9 milion euro.

Tabela 4 Tregtia në Shërbime / Bilanci Prill 2016 – Mars 2017

Viti	Eksporti i Shërbimeve <i>milion euro</i>	Importi i Shërbimeve <i>milion euro</i>	Bilanci <i>milion euro</i>
2016-2017	1,040.7	437.1	567.5

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

Të pasurit e një bilanci pozitiv të shërbimeve ka rezultuar në zvogëlimin e deficitit të lartë tregtar në mallra. Tregtia në shërbime përbën një pjesë të madhe të BPV-së, kryesisht falë prezencës së donatorëve në vend. Vlerësim i përgjithshëm i kontributit të shërbimeve në BPV ishte 73% në vitin 2015, sipas një vlerësimi nga Banka Botërore.

Tabela 5 Eksporti i Shërbimeve / Top Sektorët Prill 2016 – Mars 2017

Viti	2016-2017 <i>milion euro</i>
Udhëtimi	809.6
Shërbime tjera të biznesit	64.4
Shërbimet kompjuterike, informative dhe te telekomunikimit (ICT)	48.6
Mallra dhe shërbime qeveritare	35.8

Burim: Banka Qendrore e Kosovës

Me hyrjen e MSA-së në fuqi është parashikuar se sektori i shërbimeve do të rris eksportin e tyre nga ofruesit e këtyre shërbimeve si (komercial dhe individual) në vendet e BE-së, por një indikator që është duke ndikuar negativisht në qasjen e tregut të BE-së është jo-liberalizmi i vizave për Kosovën. Si rezultat i kësaj ofruesit Kosovar të shërbimeve nuk mundën t'i ofrojnë me kohë shërbimet e tyre, duke përfshirë edhe një kosto më të lartë si shakatarrë transporti dhe marrjes së vizave.

2.4 Procesi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit BE-Kosovë

Integrimi i mëtejshëm në ekonominë botërore në mënyrë të pashmangshme do të rezultojë me uljen e barrierave tregtare dhe do të sjellë mundësi të reja për Kosovën. Para hyrjes në fuqi të MSA-së, Kosova ka përfituar nga Masat Autonome Tregtare të BE-së. Ndërsa, procesi drejt MSA-së ka nisur në tetor 2011, kur Komisioni Evropian, përmes Raportit të Progresit, kishte rekomanduar iniciimin e Studimit të Fizibilitetit për MSA. Pas përfundimit të këtij studimi, Komisioni konstaton që Kosova ishte e gatshme për të filluar negociatat për MSA pasi të përmbushte kriteret afatshkurtra. Këto kritere afatshkurtër kishin të bënin me sundimin e ligjit, administratën publike, mbrojtjen e minoriteteve dhe tregtinë. (shih Katrorin 1 për datat e rëndësishme të procesit). Përfundimisht, MSA ka hy në fuqi më 1 prill 2016, me ç'rast raportet ekonomike dhe politike me BE janë avancuar në nivel kontraktual. Kosova ka forcuar gradualisht strukturat e saj që merren me proceset e integrimit evropian. Kosova ka themeluar një Këshill Kombëtar për Integrimin në BE kryesuar nga Presidenti. Qëllimi i këtij Këshilli Kombëtar është të mobilizojë institucionet e Kosovës për të përmbushur agjendën e reformave të BE, me ç'rast do të diskutohet në mënyrë të vazhdueshme zbatimimi i MSA-së. Lidhur me mekanizmat që Qeveria e Kosovës përdor për implementimin e kësaj marrëveshjeje, përveç dokumentit ligjor të MSA-së në vetvete që obligon Kosovën të zbatojë ligjet dhe rregullat e BE-së në fusha të ndryshme, Qeveria ka formuluar edhe dy dokumente tjerë planifikuese për zbatimin e MSA-së: Programin për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe Agjenda për Reforma Evropiane (ERA). PKZMSA është dokument më gjithëpërfshirës dhe përkrahur në vija të përgjithshme obligimet që institucionet e Qeverisë së Kosovës kanë ndaj MSA-së, ndërsa ERA shërben si dokument më specifik që fokusohet në mënyrë më të detajuar në realizimin e reformave që Kosova duhet t'i zbatojë dhe i paraqet ato në kuadër të prioritetëve afatmesme dhe masa afatshkurtra.⁸

2.4.1 Çfarë është rëndësia ekonomike e MSA-së?

- Zhvillimi gradual i zonës së tregtisë së lirë ndërmjet Kosovës dhe BE-së brenda 10 vite.
- Liberalizimi gradual i tregut të Kosovës për produktet e BE-së.
- Qasja e plotë e produkteve të Kosovës në BE.
- Qasje e bizneseve kosovare në një treg prej mbi 500 milion banorësh.
- Qasje e qytetarëve në një gamë më të madhe të produkteve dhe shërbimeve më të mira dhe me çmime më të lira.

⁸Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2017-2021, fq 10-11

- Zhvillimi, revitalizimi dhe modernizimi i ekonomisë drejt përfundimit të transicionit në ekonomi funksionale të tregut.
- Përafrimi i legjislacionit në fushën e ekonomisë.
- Përforcimi i sundimit të ligjit në fushën e ekonomisë.
- Përafrimi i politikave ekonomike me ato të Unionit Monetar dhe Ekonomik.
- Krijimi i institucioneve ekonomike të reja dhe përforcimi i institucioneve ekonomike ekzistuese.
- Përmirësimi i mjedisit afarist.
- Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve përmes qasjes në asistencë financiare dhe teknike të ofruar nga BE dhe përmes bashkëpunimit në pranimin më të shpejtë të njohurive dhe në qasjen në teknologji të reja.
- Bashkëpunim në hulumtime dhe zhvillim teknologjik.
- Përkrahje në përforcimin e sektorit bankar, të sigurimeve dhe të shërbimeve financiare.
- Rritja e investimeve të huaja direkte.
- Rritja e investimeve vendore.
- Rritja e konkurrencës dhe stimulimi i eksportit.
- Përafrimi i legjislacionit në fushën e punësimit.
- Përkrahje në arritjen e standardit adekuat të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në përputhje me Procesin dhe Deklaratën e Bolonjës.
- Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe materiale të qytetarëve.
- Krijimi i vendeve të reja të punës.
- Përkrahje për stabilitet makroekonomik në rast nevojë përmes asistencës financiare në formë të granteve dhe kredive.

2.4.2 Detajet e pjesës tregtare të MSA-së

- Të gjitha produktet industriale dhe bujqësore të Kosovës do të eksportohen në BE pa tarifë doganore.
- Sidoqoftë, kuotatat e caktuara janë të vendosura, si për shembull tarifa doganore në BE nuk vlen deri në volumin prej 15 tonë për vit për peshkun troftë. Kuota për krap është 20 tonë në vit. Pas kësaj sasi, aplikohet tarifa doganore e BE-së.
- Është rritur kuota e eksportit të verës nga 20,000 hekto litra në 50,000 hekto litra.

2.4.3 Koncesionet e BE-së për prodhimet industriale të Kosovës

- Të gjitha produktet industriale të Kosovës do të eksportohen në shtetet e BE-së me tarifë doganore zero (0).

2.4.4 Koncesionet BE-së për produktet bujqësore të Kosovës

- Të gjitha produktet bujqësore të Kosovës do të eksportohen në shtetet e BE-së me tarifë doganore zero (0).

2.4.5 Koncesionet e Kosovës ndaj produkteve industriale të BE-së

- Kosova ka shfuqizuar tarifën doganore për 3,023 linja tarifore të produkteve industriale me hyrjen në fuqi të MSA. Këto produkte nuk prodhohen në Kosovë dhe ne nuk kemi kapacitete për prodhimin e tyre.

- 1,131 produkte do të liberalizohen gradualisht brenda një periudhë prej 5 vitesh (*pajisjet televizive, telefonat mobil, printerë, pajisje për bankënota, kamera për incizim dhe kamerat digjitale, kripë, kuarç, mermer, llaç, çimento, disa mallra farmaceutike dhe kirurgjikale, parfume, vajra dhe kozmetikë, sapun, gomë natyrore, artikuj lëkure, materiale tekstili dhe pëlhura, pllaka qeramike, prodhime gresi, porcelan, disa metale dhe metale të çmuar, mjete për punë dore, pajisje mekanike dhe shtëpiake, etj*).
- 925 produkte do të liberalizohen gradualisht brenda një periudhe për 7 vjet nga hyrja në fuqi e MSA-së (*ngjyra, kozmetikë, parfume, produkte plastike, artikuj shtëpiake dhe të tualetit, artikuj higjienike dhe farmaceutike, artikuj druri, artikuj letre, artikuj të ndryshme tekstili, veshje, produkte çeliku dhe hekuri, gypa dhe tuba, rezervuarë, fuçi, pajisje shtëpiake, automjete motorike, artikuj elektrikë, pajisjet kompjuterike, etj*).

2.4.6 Koncesionet e Kosovës ndaj produkteve bujqësore të BE-së

- Kosova, që nga hyrja në fuqi e MSA-së, ka shfuqizuar tarifën doganore për 1,044 nga 2,564 produkte bujqësore nga BE-ja. Ndërsa 164 produkte bujqësore të BE-së tashmë janë të liruara nga tarifa doganore me Ligjin Nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor.
- 14 produkte kanë qenë të pa-negociueshme dhe nuk janë përfshirë në marrëveshje, gjë që do të thotë se tarifa Kosovare do të mbetet e njëjtë (10%) për ato produkte (që kryesisht përfshijnë produkte të *qumështit, krem, jogurt, patate, molle, verë*).
- 12 produkte shumë të rëndësishme për prodhimin bujqësor të Kosovës (8 bujqësore dhe 4 të përpunuara bujqësore) janë mbrojtur dhe tarifa doganore do të reduktohet gradualisht brenda një periudhe 10 vjeçare nga hyrja në fuqi e marrëveshjes (*produkte të qumështit, fruta dhe perime, ujë, birra dhe produkteve të grurit*).
- 256 produkte sensitive bujqësore (180 bujqësore dhe 76 të procesuara bujqësore) të rëndësishme për fermerët e Kosovës do të jenë të mbrojtura dhe tarifa doganore e tyre do të reduktohet gradualisht brenda një periudhe 7 vjeçare (*lëngje frutash si lëng molle, o, luleshtrydhe, kumbulla etj, xhem dhe marmelatë, patate, miell, mish dhe mish i shpezëve, uthull si dhe djathë, etj*).
- 451 produkte (prej tyre 353 bujqësore dhe 98 produkte të proceduara bujqësore) do të lirohen nga detyrimet doganore gradualisht brenda një periudhe prej 5 viteve (*produktet mishit të bagëtive, pulave, qumësht dhe krem, produkte nga yndyra e qumështit, lule me petale për përdorim, qepë, hudhër, disa perime, disa fruta të caktuara dhe produkte të familjes së arrave, produkte të kafesë, çaj, biber, vanilje, oriz, drithëra, vaj, fruta si dardha, rrush, manaferrat, pjeshkë, , lëngje frutash, etj*).

2.4.7 Koncesionet e Kosovës ndaj BE-së për produktet e peshkut

- Me hyrjen në fuqi të MSA-së, Kosova ka shfuqizuar tarifën doganore për 487 produkte të peshkut.
- Sa i përket troftës, tarifa do të hiqet gradualisht për një periudhë 7 vjeçare, ndërsa për krapë gradualisht për 5 vite.

KUTIA 1: DATAT E RËNDËSISHME LIDHUR ME NEGOCIATAT PËR MSA

Në renditjen kronologjike, mund të gjeni në vijim ngjarjet që çuan në realizim të MSA-së:

Dhjetor, 2012 – Këshilli Evropian (KE) ka konfirmuar progresin dhe mundësinë e hapjes së negociatave për MSA midis Kosovës dhe BE-së;

Prill, 2013 – KE ka konfirmuar se Kosova ka plotësuar kriteret afatshkurtra për sundimin e ligjit, administrimin publik, të drejtat e pakicave dhe tregtinë;

Qershor, 2013 – duke marrë parasysh plotësimin e kriterëve afatshkurtra, KE-ja ka vlerësuar arritjet dhe ka konfirmuar fillimin e negociatave për MSA;

28 Tetor, 2013 – është mbajtur mbledhja e parë midis Qeverisë së Kosovës dhe KE-së për të negociuar MSA-në. Mbledhja e dytë u mbajt në 27 nëntor, 2013;

2 Maj, 2014 – është mbajtur mbledhja e tretë dhe e fundit për negociatat e MSA;

25 Korrik, 2014 – përfunduan negociatat për MSA midis Kosovës dhe BE-së;

27 Tetor, 2015 - MSA u nënshkrua në Strasburg;

30 Tetor, 2015 - MSA u miratua nga Qeveria e Kosovës;

2 Nëntor, 2015 - MSA u ratifikua nga Kuvendi

1 Prill, 2016 - MSA ka hyre ne fuqi

Kapitulli 3: Analiza e zbatimit të MSA-së

3.1 Ndikimi në Tregti me Mallrat

Marrëdhëniet tregtare të Kosovës me vendet e bllokut evropian, përkatësisht volumi i qarkullimit tregtar të mallrave me vendet BE-së gjatë vitit 2016 ka shënuar vlerën prej 1.2 miliard euro më e lartë për 4.4% krahas vitit 2015. Kështu 41% e tërë volumit tregtar të Kosovës ka qenë e realizuar me vendet e BE-së. Mirëpo, sa i përket eksporteve një pjesë e madhe e mallrave të eksportuara (pas CEFTA-së) kanë shkuar drejt vendeve të BE-së duke arritur në 70 milion euro ose 22.6 % e totalit të eksporteve me një rënie prej 34% në raport me vitin paraprak (2015) dhe po ashtu 28.6% më e ulët ndaj vitit 2014.

Kosova është ballafaquar me rënie të çmimeve në tregun global për produktet e saj më të eksportuara, ky zhvillim është shoqëruar me rënien e çmimeve të metaleve e veçmas të nikelit e cila ka ndikuar në rënien jashtëzakonisht të lartë të eksporteve, për më tepër, indikacione për trende negative të rënies së eksporteve është shfaqur kryesisht në vendet e BE-së. E themi këtë ngase gjatë vitit 2015 eksportet në vendet e BE-së e ka përfaqësuar eksporti i nikelit me pjesëmarrje prej 42.3% të totalit të eksporteve drejtuar në BE. Ndërsa, në vitin 2016 eksporti i nikelit e përfaqëson eksportin total në BE me vetëm 5.6% ose e shprehur në vlerë për €3.9 milion (më e ulët për €40.9 milion ndaj vitit 2015, ose e shprehur në përqindje më e ulët për mbi 78% në vitet 2014 dhe 2015).

Sa i përket bilancit tregtar për mallra bujqësore BE – Kosovë, importet e mallrave bujqësore tejkalojnë eksportet e cila rezulton me deficitin e lartë tregtar. Gjatë viteve të fundit, ka pasur një rritje të eksporteve për mallra bujqësore (në total për kapitujt 0 – 24). Andaj, me eksportet e mallrave bujqësore me destinacion vendet e BE-s, shifrat për vlerën eksporteve janë rritur për 13.5% në 2016 krahas vitit paraprak. Produktet bimore dhe produktet industriale ushqimore dhe pijet mbeten një potencial i konsiderueshëm për të rritur nivelin e eksportit. Kështu, vlera e eksporteve sipas kategorizimit të mallrave bujqësore tregon se kemi një rritje të eksporteve për produkte bimore dhe kategoria e produkteve ushqimore të përgatitura dhe pijet. Pavarësisht nivelit të rritjes jo shumë të lartë e shprehur në vlera, ato mbeten si burime të mëdha për prodhim si dhe potencial të rritjes dhe qëndrueshmërisë ekonomike. Pra, nga krahasimi i treguesve real të tregtisë, rezulton se sektori i industrisë së ushqimit dhe pijeve edhe ai bimor ka tendencë rritje dhe kjo rritje premtion një trend pozitiv që do të ndihmojë në përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e përparësive konkurruese dhe mbulojnë 17% të eksporteve të përgjithshme në drejtim të BE (2016). Megjithatë, mund të konsiderohet që vendet më të rëndësishme për eksportin vendor janë Gjermania, Holanda, Bullgaria, Austria, Italia, etj (2016). Ndërsa, importet nga BE arritën në 1 miliard e 202 milionë euro, rritje prej 8% nga viti 2015, po ashtu rritje për 11.2% nga ai i vitit 2014. Kosova importon mallra kryesisht nga Gjermania, Italia, Greqia, Polonia, Sllovenia dhe Kroacia, (2016).

Nga analiza e të dhënave statistikore për periudhën pas lidhjes së marrëdhënieve kontraktuale Kosovë – BE, përkatësisht pas nënshkrimit të MSA-së siç tregohet në tabelën e mëposhtme eksportet totale në BE shfaqin tendencë negative krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Kështu, ato shënuan rënie prej 34 për qind ose nga afër 79 milion euro në 52 milion euro

ndërmjet periudhës kohore Prill – Dhjetor 2015 – 2016. Por, në përgjithësi, shkëmbimet tregtare Kosovë – BE u rritën për afër 3%.

Megjithatë, tendenca e ndryshimit të volumit në importe është më pak e theksuar se sa ajo që vërehet për eksporte, pra një rritje e importit ndodh në mes periudhës kohore Prill – Dhjetor 2016 për 6% në raport krahasues me periudhën e njëjtë të vitit 2015. Këto importe mbesin në nivel të lartë nga e gjithë pjesa e partneritetit tregtar. Mallrat e importuara nga BE përfaqësojnë 43% të tërës vlerës së importit në Kosovë. Në fakt rritja e mëtejme e deficitit të tregtisë së mallrave në masë të madhe e mundësoj rënia e çmimeve të kategorisë së metaleve bazë dhe mineraleve në tregun ndërkombëtar. Andaj, niveli i vlerave të eksportit dhe gama shumë e kufizuar e mallrave me origjinë kosovare është një tregues që shpreh nivelin e konkurrueshmërisë në raport jo vetëm me ekonominë e vendeve të zhvilluara por edhe me vendet me ekonomi në zhvillim si ato të rajonit. Në fakt, kur merret parasysh tregtia e produkteve bujqësore dhe jo bujqësore midis Kosovës dhe BE, ka vetëm pak produkte që Kosova është në gjendje të eksportoje në BE dhe një gamë të gjerë produktesh të importuara po ashtu nga BE. Shikuar gjendje aktuale të shkëmbimeve tregtare Kosovë – BE, (periudhën kohore Janar – Prill 2016 – 2017) shohim një rritje të nivelit të eksporteve në masën rreth 6.6 % dhe po ashtu rritje të importeve për 8.6%.

Tabela 6 Eksporti (Prill – Dhjetor 2015- 2016)

Prill - Dhjetor 2015	Prill - Dhjetor 2016	Diferenca 2016- 2015	↑↓ 2016/2015	IV - XII 2015, pjesëmarrje	IV- XII 2016, pjesëmarrje
milion Euro	milion Euro	milion Euro	%	%	%
78.9	52.1	-26.8	-34.0	31.7	22

Tabela 7 Importi (Prill – Dhjetor 2015- 2016)

Prill - Dhjetor 2015	Prill - Dhjetor 2016	Diferenca 2016- 2015	↑↓ 2016/2015	IV - XII 2015, pjesëmarrje	IV- XII 2016, pjesëmarrje
milion Euro	milion Euro	milion Euro	%	%	%
907.2	962.5	55.30	6.1	42	43

3.2 Ndikimi në Tregti me Shërbimet

Sipas MSA-së, neni 55 parasheh që një kompani e BE-së e themeluar në Kosovë apo një kompani kosovare e themeluar në BE, në përputhje me legjislacion në fuqi në vendin e themelimit, ka të drejtë të punësojë në një degë të saj punëtorë të cilët janë shtetas të BE-së apo Kosovës respektivisht, nëse ky personel është personel kyç – i specifikuar me paragrafin 2 të këtij neni.

- MTI ka hartuar ligjin nr.04/L-220 për Investimet e Huaja, që shtetasve të huaj iu jep të drejtë të punësojnë ose në ndonjë mënyrë tjetër të kontraktjnë persona fizik që janë shtetas të një vendi të huaj për qëllim të angazhimit të personave të tillë për të siguruar apo performuar në Republikën e Kosovës, shërbime profesionale, të menaxhimit, administrative, mbikëqyrjes, apo të konsultimit ose funksione teknike. Gjithashtu personave të tillë fizik do t’iu lejojë të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Kosovës për periudhën e kërkuar me kontratën e tyre me investitorin e huaj në pajtim me ligjin e aplikueshëm.
- Kosova ka ndërmarrë masa për të ndihmuar shtetasit e huaj në fusha të caktuara. Për shembull, në sektorin e ndërtimit Kosova njihet licenca të huaja duke bërë lehtësime për kompanitë e huaja që të sjellin punëtorë për të punuar në Kosovë. Avokatëve, të cilët janë banorë të përhershëm, iu është lejuar edhe të ofrojnë shërbime në Kosovë.
- Direktiva e Shërbimeve obligon vendet anëtare të krijojnë një “Pikë të Vetme Kontakti” dhe të marrin pjesë në një sistem elektronik të informacionit për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunim në mbikëqyrjen e shërbimeve midis vendeve anëtare.

Kërkesat e MSA-së

Dispozitat kryesore të MSA që rregullojnë këtë fushë janë të përfshira në nenet 51, 56, 57, 58, 59 dhe 74. Sipas nenit 51, Kosova obligohet që me hyrjen në fuqi të MSA-së të sigurojë trajtim të barabartë të kompanive të BE-së me ato vendore sa i përket kushteve të punës, pagesave dhe trajtimit të punëtorëve dhe subjekteve juridike të cilët themelohen juridikisht në territorin e Kosovës. Neni 57 i MSA-së definojnë që pas 6 viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizimit Asocimit (KSA) duhet të krijojë modalitetet për të zgjeruar dispozitat e kapitullit mbi ofrimin e shërbimeve për shtetasit e BE-së dhe qytetarëve të Kosovës. Neni 58 i MSA-së obligon Kosovën që pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, KSA-ja të marrë masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë progresive lejimin e ofrimit të shërbimeve nga kompanitë e BE-së, nga kompanitë kosovare ose nga shtetasit e BE-së dhe qytetarët e Kosovës të cilat janë të vendosur në territorin e njëjës Palë, për persona tjerë përveç atyre për të cilët dedikohen shërbimet.

Departamenti i Tregtisë (MTI) ka hartuar Ligjin për Shërbime i cili transponon direktivën e BE-së Nr. 2006/123/KE për Shërbimet në tregun e brendshëm. Ligji i ri për Shërbime Nr. 05/L-130 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe ka hyrë në fuqi në muajin Mars 2017. Nga ky ligj dalin obligime shtesë për harmonizimin e të gjitha akteve ligjore dhe akteve nën-ligjore të Kosovës me këtë ligj. Gjithashtu, është paraparë nxjerrja e akteve nën-ligjore për zbatimin e këtij ligji. Nxjerrja e dy akteve nën-ligjore, përkatësisht Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Pikës së Vetme të Kontaktit dhe Udhëzimit Administrativ për Mënyrën e Njoftimit për Aktet e Reja Ligjore, janë në procedurë dhe do të përfundojnë gjatë vitit 2017.

Ndërsa, sa i përket njohjes së përbashkët të kualifikimeve profesionale me vendet e rajonit janë mbajtur takime të rregullta në dy vitet e fundit. Tanimë është konfirmuar nga vendet anëtare të CEFTA-së hapja e negociatave për njohjen e përbashkët të kualifikimeve profesionale për katër sektorët e përzgjedhur me interes të përbashkët për njohje të kualifikimeve. Sektorët në të cilët pritet të fillojnë negociatat në fund të vitit 2017 janë: Doktorët, Dentistët, Arkitektët dhe Inxhinierët.

Projekti i financuar nga BE, Asistence në zbatimin e MSA-së Direktivës së BE-se për Shërbimet

Në muajin Maj 2016 ka filluar punën projekti i financuar nga BE “Asistence në zbatimin e MSA-së Direktivës së BE-së për Shërbimet”. Objektivi kryesor i këtij projekti është të lehtësojë përafrimin e BE-së duke mbështetur harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së në fushën e shërbimeve. Dispozitat e Direktivës kanë për qëllim thjeshtësimin e procedurave administrative, heqjen e pengesave për aktivitetet e shërbimeve, si dhe rritjen e besimit reciprok midis Shteteve Anëtare dhe besimit të ofruesve dhe konsumatorëve në tregun e brendshëm.

Projekti ndahet në tri komponentë:

- Legjislacioni- Shqyrtimi gjithëpërfshirës dhe harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit mbi shërbimet (Ligji për Shërbimet)
- Thjeshtimi i procedurave dhe propozimi për krijimin e Pikave të Kontaktit të Vetëm (PVK)
- Ngritja e Kapaciteteve dhe Ngritja e Ndërgjegjësimit

3.3 . Mbrojtja e tregut

Mbrojtja e tregut në Kosovë është e rregulluar me dy ligje bazike, në harmoni me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë:

1. Ligji mbi masat anti-dumping dhe masat kundër-balancuese dhe
2. Ligji mbi masat mbrojtëse në importe.

Sipas MSA-së, kapitulli 3 neni 42-43 parasheh mbrojtjen e tregut, ku kjo marrëveshje nuk i pengon palët që të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e tregut nga importet në tri forma: në formën e sasisë së rritur të importeve; në formën e çmimit të deklaruar nga importuesit (çmim jo-real) dhe në formën e subvencionimit nga Qeveria e vendit përkatës.

Kapitulli 4: Konkluzionet

Hapja e tregut luan një rol të rëndësishëm në ekonomi në shumë aspekte. Është dëshmuar se tregtia ndërkombëtare është një nga faktorët më të rëndësishëm të rritjes dhe zhvillimit ekonomik, duke rezultuar në të ardhura më të larta dhe rritje të mirëqenies për shoqërinë.

Dihet se procesi i anëtarësimit në BE ka efekte të rëndësishme pozitive, pavarësisht ndikimit fiskal të kësaj marrëveshjeje në Kosovë, humbja e të ardhurave të qeverisë, e vlerësuar në rreth 25 milionë euro. Negociimi i MSA-së hap tregun e BE-së për bizneset e Kosovës; siguron qasje në teknologji, ekspertizë, etj.; zgjeron mundësitë e tregtisë dhe investimeve; sjell efekte pozitive të përhapjes tek prodhuesit e brendshëm, sepse krijon konkurrencë të re, nevojën për inovacione dhe për të qenë në hap me teknologjitë e reja. Përveç kësaj, zgjerimi i tregut rrit kredibilitetin e vendit sa i përket rregullave dhe rregulloreve, si dhe kornizës institucionale. Ndikimi i hapjes së tregut në tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte (IHD), është e një rëndësie të madhe për ekonominë në zhvillim dhe tranzicion si Kosova. Vlen të theksohet se nga perspektiva e Kosovës, liberalizimi i tregtisë ofron mundësinë e lidhjes së prodhuesve vendas me zinxhirët global të vlerës. Ka gjasa që këto efekte të nxitin rritjen, rritjen e punësimit dhe zbutjen e varfërisë. Krijimi i vendeve të punës nënkupton të hyra më të mëdha dhe, si rezultat, standard më të mirë jetese - ose në përgjithësi mirëqenie e përmirësuar.

Mirëpo, përvojat tjera na tregojnë se përfitimet nga liberalizimi i tregtisë kushtëzohen nga faktorët e ofertës. Ky është edhe rasti me Kosovën. Edhe pse baza e prodhimit në Kosovë është e pakët, me angazhimin e prodhuesve vendas dhe mundësive të reja që kjo hapje e tregtisë pritet të sjellë, kjo bazë e prodhimit përfundimisht do të zgjerohet. Megjithatë, nëse performanca institucionale nuk përmirësohet më tej në mënyrë që të krijojë kushte edhe më të favorshme për bizneset dhe investimet e reja, liberalizimi i tregtisë mund të mos jep plotësisht rezultatet e dëshiruara, të cilat ndikojnë si në përfitimet e konsumatorëve, ashtu edhe të prodhuesve. Për të shfaqur rezultate të rritjes së fuqishme, kjo duhet të shoqërohet me politika të përshtatshme siç janë arsimimi më i mirë dhe nivele më të larta të aftësive, infrastruktura më e mirë, stabiliteti financiar dhe makroekonomik, etj.

Përveç gjërave të lartpërmendura, një tjetër gjë shumë e rëndësishme të cilën Kosova do të mund ta përfitoj nga BE-ja në përgjithësi, dhe nga MSA-ja në veçanti, është ndihma financiare dhe teknike. Ky lloj i mbështetjes pritet të luajë rol të rëndësishëm në nxitjen e zbatimit të reformave që kanë të bëjnë me arsim, trajnim, shërbim bankar dhe financa, promovim të NVM-ve dhe stabilizim makro-ekonomik. Përveç kësaj, një pjesë e ndihmës financiare të BE-së sigurohet në formë të granteve që do t'i shpërndahen sektorit industrial dhe bujqësor për të përmirësuar ekonominë e Kosovës.

Përtej asaj se MSA eshët një marrëveshje asimetrike ndërmjet Kosovës dhe BE-se që do të thotë se që nga momenti i hyrjes në fuqi të saj ndonëse të gjitha e produktet nga Kosove do të kenë qasje të plot në tregun e BE-se përveç atyre të negociuara përmes kuotave, përderisa qasja e prodhimeve të BE-se në tregun e Kosovës do të liberalizohet sipas periudhave kohore, 5, 7 dhe 10 vjeçare. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se përkundër asaj që u tha me lart, Kosova ende e ka të pamundur që produktet me origjinë shtazore të eksportohet në tregun e BE-se. Kjo për

faktin se ende sipas rregullores së BE-së nr. 206/2010 Kosova nuk gjendet në listën e shteteve për eksportin e këtyre produkteve me origjinë shtazore. Qe do të thotë se Kosova ende e ka të pa mundur të realizoj eksportin e këtyre produkteve në tregun e BE-së. Gjithsesi, është shqetësuese sepse rrjedhimisht zbatimi i MSA-së mund që të mos na sjell përfitimet e pritura nëse në listat e BE-së ekzistojnë kufizime në të cilat Kosova nuk figuron. Edhe pse mbetet barrë edhe e institucioneve të Kosovës që të bëjë përpjekjet maksimale për zgjidhjen e kësaj pengese.

Në përgjithësi, duket e arsyeshme të konkludohet se MSA-ja do t'i sjell dobi ekonomisë dhe bizneseve të Kosovës, duke siguruar mundësi tjera për të tejkaluar pengesat aktuale nga ana e ofertës, të cilat konsiderohet se janë problem kryesor në ekonominë e Kosovës. Më e rëndësishmja, përparësitë e Marrëveshjes mbi Tregtinë e Lirë në kuadër të MSA-së mund të përdoret si mënyrë për të rritur nivelin e produktivitetit, faktor tjetër i rëndësishëm, i cili përcakton konkurrencën ndërkombëtare të bizneseve në Kosovë. Prandaj, për Kosovën, është më tërheqëse një marrëveshje me bllokun më të madh tregtar në botë. Bizneseve kosovare do t'u jepet qasje tek 500 milionë konsumatorë në 28 shtetet anëtare të BE-së. Bizneset do të përfitojnë nga MSA-ja me uljen e barrierave tregtare dhe krijimin e një mjedisi më të qëndrueshëm dhe transparent tregtar dhe të investimeve; për kompanitë gjithashtu do të jetë më e lehtë dhe më e lirë të eksportojnë prodhimet e tyre në tregjet partnere tregtare. Përveç kësaj, përfitimet nga MSA-ja shkojnë përtej tregtisë, sepse BE-ja lidh MSA-të në këmbim të zotimeve për reformë politike, ekonomike dhe tregtare në një vend. Në këtë aspekt, Kosova do të mund të bëjë përparime të mëdha në fushat si pronësia intelektuale, prokurimi publik, politika e konkurrencës, tregtia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.